



GJETJE NGA RAPORTI I VLERËSIMIT

MBI PRAKTIKAT E MEKANIZMIT TË BUXHETIMIT ME
PJESËMARRJE DHE KONSULTIMIT NË NIVEL VENDOR

NË BASHKINË FIER

SHTATOR 2019



GJETJE NGA RAPORTI I VLERËSIMIT

MBI PRAKTIKAT E MEKANIZMIT TË BUXHETIMIT ME

PJESËMARRJE DHE KONSULTIMIT NË NIVEL VENDOR

NË BASHKINË FIER

SHTATOR 2019



GJETJET NGA BASHKIA FIER

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Reforma Administrative Territoriale e vitit 2015 pati një ndikim të ndjeshëm edhe në Bashkinë Fier. Me ndarjen e re territoriale, Bashkia përfshiu në juridiksionin e saj dhe 9 ish-komuna (sot njësi administrative). Sot Bashkia Fier ka 13 njësi administrative (4 rajonet e qytetit dhe 9 njësi administrative: Levan, Frakull, Cakran, Portëz, Dërmëndas, Qendër, Mbrostar, Libofsh dhe Topojë). Si rezultat i RAT, Bashkia e Fierit njohu një rritje me rreth 130% të popullsisë dhe 48% të territorit. Numri i banorëve sot është 204.548, kurse sipërfaqja shkon në 619.9 km². Bashkia e Fierit renditet e pesta në rang kombëtar përsa i përket numrit të popullsisë dhe e treta për nga rëndësia ekonomike.

STAFI I BASHKISË

Për përgatitjen e këtij raporti, u pyetën 10 punonjës të bashkisë Fier, të cilët përfshijnë: staf drejtues dhe specialist nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, Punëve Publike dhe Transportit, Turizmit dhe Promovimit të Vlerave, Shërbimit Social, Marrëdhënieve me Publikun, Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Hartimit të Projekteve për Investimet e Huaja dhe Vendase. Të gjithë të intervistuarit përfaqësojnë drejtoritë që janë të përfshira në procesin e BP.

- Nga intervistimi i bërë në lidhje me vlerësimin e praktikave të mekanizmit të BP dhe konsultimit në nivel vendor, u vërejt që të gjithë të intervistuarit kishin informacion që një model i tillë zhvillohej, por nuk dinin detaje dhe procedura në lidhje me ecurinë e tij. Shpesh shumë pyetje u lanë pa përgjigje nga të intervistuarit, fakt që tregon një mungesë ose paqartësi informacioni në lidhje me këtë proces të rëndësishëm jo vetëm për qytetarët, por mbi të gjitha nga institucioni i vetëqeverisjes vendore.
- BP është një proces që ka nisur të zbatohet në Bashkinë Fier që nga viti 2009 dhe të gjithë punonjësit e bashkisë të intervistuar ishin në dijeni të zhvillimit të këtij procesi, por vetëm 20% e tyre e konsideronin atë një proces. Sipas tyre, ky buxhetimi me pjesëmarrje është iniciuar kryesisht nga Bashkia (60%) dhe nga donatorët (40%). Gjithashtu, në Bashkinë Fier prej disa vitesh bëhet edhe Buxhetimi Ginor.
- Vetëm 20% e tyre e veçonin BP si një ndër mekanizmat e konsultimit publik që ka rezultuar më efektiv në Bashkinë Fier, ndërkohë që vlerësohen në masën 40% takimet publike tematike me qytetarët. Me interes është procesi i konsultimit që Bashkia Fier bën për hartimin e programit buxhetor afatmesëm, i cili kryhet përmes Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), e raportuar nga 20% e të intervistuarve.
- Në Bashkinë Fier nuk ka ende vendime apo rregullore të miratuara nga Kryetari i Bashkisë apo Këshilli Bashkiak në lidhje me procesin dhe zbatimin e BP, të cilat do ta saktësonin këtë proces dhe do e bënin atë lehtësisht të aksesueshëm dhe monitorueshëm.

- Në përgjithësi, hapat e procesit BP në etapa të ndryshme njihen prej të intervistuarve, por shprehen se mungon një model i mirëfilltë mbi bazën e të cilit të zhvillohet procesi nga nisja deri në përfundimin e tij.
- Në lidhje me pyetjen përse nuk ka një të tillë, shumica e të intervistuarve japin përgjigje të ndryshme, të tilla si “nuk është e nevojshme”, “s’ka praktikë për t’u përshtatur në Bashkinë Fier”, “janë mekanizmat ligjorë që e orientojnë procesin BP” apo që “është në proces”, të cilat dëshmojnë që informacioni që ekziston në lidhje me organizimin aktual është i paqartë dhe i pamjaftueshëm.
- Të pyetur për formën e organizimit të procesit BP, sërish vërehet që ka konfuzion dhe mungesë të njohjes së informacionit të saktë mbi hapat dhe ecurinë e procesit. 40% e të intervistuarve listojnë disa nga hapat kryesorë, por jo të gjithë të intervistuarit kanë dijeni për procesin si të tërë. 20% e tyre e mendojnë procesin vetëm përmes njoftimeve në faqen e Bashkisë dhe rrjetet sociale dhe vetëm 10% e dinë që shoqëria civile dhe qytetarët duhet të marrin pjesë nëpër takime.
- Mungesa e një standardi (rregullor apo vendim nga Kryetari apo KB) reflektohet edhe në pyetjen që ka të bëjë me strukturën përgjegjëse për organizimin e BP-së. Përgjigjet tregojnë konfuzion dhe mungesë informacioni. E njëjta situatë paraqitet edhe në pyetjen se kush janë sektorët apo drejtoritë në bashki që përfshihen në këtë proces. 20% e të intervistuarve nuk janë në dijeni, ndërsa pjesa më e madhe e tyre e shohin të lidhur me sektorët që merren me shërbimet publike dhe financat.
- Të pyetur për format e njoftimit dhe përfshirjes qytetare, të gjithë të intervistuarit raportojnë se lajmërimet përmes mediave sociale, mediave lokale dhe afishimi në ambjentet e bashkisë ishin mënyrat më të përdorura nga bashkia. Të intervistuarit mendonin që regjistri elektronik, komunikimi përmes email, njoftimet individuale dhe botimet në gazetat përdoren më pak për këtë proces.
- Sipas tyre, sigurimi i gjithë grupeve të synuara në BP arrihet përmes rrugëve të mësipërme, duke shtuar edhe punën e administratorëve të njësive vendore. Por asnjë nuk përmend ose nuk ve në dukje rolin e rëndësishëm të ndërmjetësit komunitar në qytet. Zgjidhjen për përmirësimin e formave të njoftimit dhe përfshirjes së qytetarëve e shohin vetëm në rritjen e interesit të këtyre të fundit, duke u shprehur që ka nivel të ulët interesimi për këtë proces dhe jo vetëm.
- Statistikat vazhdojnë të mbeten një problem në nivel lokal, kjo edhe në rastin e buxhetimit me pjesëmarrje. Ndërkohë që mungojnë të dhënat zyrtare, të intervistuarit me hamëndje u shprehën që numri total i qytetarëve të përfshirë në BP mund të arrijë në 1,200-1,500, nga të cilët 100-250 duhet të jenë nga qyteti dhe pjesa tjetër nga njësitë administrative (70-80 për NJA). Në këtë realitet nuk bëhet fjalë për të dhëna të tjera të

ndara sipas kategorive (gjinore, biznese, të rinj, njerëz në nevojë, etj), që do ta ndihmonin bashkinë në adresimin më mirë të nevojave të tyre.

- Në lidhje me regjistrin elektronik shumica e të intervistuarve (60%) nuk e dinin fare nëse ka apo jo një regjistër të tillë. Vetëm 40% e tyre ishin në dijeni të strukturës përgjegjëse për mbarëvajtjen e regjistrit elektronik. Nga informacionet e marra mësohet se ky regjistër ekziston në Bashkinë Fier, rifreskohet herë pas here, por nuk është i publikuar. Aktualisht po punohet edhe për një udhëzim në lidhje me procesin, që do të krijonte një praktikë të mirëpërcaktuar në lidhje me hapat e duhur për mirëfunksionimin e regjistrit elektronik.
- Përsa i përket monitorimit, punonjësit e Bashkisë shprehen se nuk ka një mekanizëm të ngritur, por sipas tyre zhvillimi i investimeve dhe takimet me komunitetin janë monitorimi më i mirë që i bëhet performacës dhe kënaqësisë së qytetarëve ndaj punës së Bashkisë.
- Një nga sfidat që identifikohet nga të intervistuarit ka të bëjë me angazhimin më të mirë të qytetarëve në këtë proces dhe informim më efektiv të tyre për rolin dhe kompetencat e Bashkisë. Megjithatë ata mendojnë (50%), që BP ka shërbyer për rritjen e aktivizimit qytetar dhe duke qenë monitoruesit më të rregullt të punës së Bashkisë përditë, qytetarët e bëjnë më të mirë këtë proces.
- Nevojat që duhet të adresohen sipas të intervistuarve për përmirësimin dhe mbarëvajtjen e procesit BP kanë të bëjnë më shumë me burimet e nevojshme financiare (70%) dhe asistencën e duhur teknike (60%), përfshirë përcaktimin e procedurave (40%) dhe trajnimin (30%) që do të saktësonin dhe lehtësonin këtë proces. Infrastruktura e përshtatshme, së bashku me burimet njerëzore dhe ato materiale, luajnë një rol të rëndësishëm sipas tyre në këtë proces.

GJETJET KËSHILLI BASHKIAK

Pas zgjedhjeve vendore 2015, Këshilli Bashkiak numëronte 41 këshilltarë vendorë, nga të cilët 19 gra (46.4%) dhe 22 burra (53.6%). Kjo deri në vitin 2019, pasi rritja e popullsisë në vitin 2018 në Bashkinë Fier, ku kaloi kufirin e 200,000 banorëve, e çoi numrin e këshilltarëve në 51. Këshilli i ri i Bashkiak i dal si rezultat i zgjedhjeve lokale të mbajtura në 30 qershor 2019 ka në përbërjen e tij 25 gra (49%) dhe 26 burra (51%), kryesisht të forcës së majtë. Sipas burimeve zyrtare, po punohet për ristrukturimin dhe fuqizimin e Aleancës së Grave Këshilltare, strukturë e ngritur para pak kohësh në Këshillin Bashkiak Fier.

Për përgatitjen e këtij raporti, u pyetën 10 ish-anëtarë të Këshillit Bashkiak Fier, nga të cilët 9 të forcës politike të majtë (PS) dhe 1 të forcës së djathtë (LSI). Pjesa më e madhe e këshilltarëve të intervistuar janë pjesë edhe e Këshillit të ri të Bashkisë Fier.

- Nga intervistat e bëra rezultoi se të gjithë këshilltarët e shikonin shumë të rëndësishme dhe të rëndësishme pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimarrjen vendore. Sipas tyre kjo

çon në orientim dhe ndarje më më të drejtë të vendimarrjes dhe investimeve publike; rritje të aktivizmit qytetar dhe identifikim më të mirë të problematikave; nxitje të zhvillimit të politikave të reja dhe rritje të besueshmërisë përmes vendimarrjes së përbashkët.

- Të gjithë të intervistuarit mendonin se e njihnin bazën ligjore dhe se ajo ishte e qartë dhe e plotë, por ka ende për të bërë në mënyrën e zbatimit, e cila ishte e paqartë për këshilltarët. Për këtë ata sygjerojnë të ketë një material të shkruar paraprak (të hartuar nga këshilltarët) që do të evitonte shfletimin e detyrueshëm të legjislacionit në çdo moment për një proces kaq të thjeshtë e specifik. Këshilltarët mendojnë që një pjesë e buxhetit duhet të përdoret për nevojat specifike të procesit, siç është dhe një material procedural.
- Nuk ka një rregullore apo procedura të brendshme të miratuara për realizimin e procesit të BP edhe pse disa prej tyre pohuan të kundërtën, por asnjëherë nuk e sqaruan këtë pikë.
- Përsa i përket bashkëpunimit mes Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë për procesin e BP-së shihet një ndarje politike ku 9 prej tyre mendojnë që ka bashkëpunim, kurse përfaqësuesi i opozitës e mohon. E njëjta ndarje vërehet edhe në pyetjen për infrastrukturën e realizimit të procesit. Sipas tyre bashkëpunimi realizohej përmes:
 - Komisioneve të ngritura ad hoc;
 - Angazhimit të Këshillit Bashkiak që në hartimin e kalendarit të dëgjësave dhe marrjen pjesë e disa prej tyre në to.
 - Takime për çështje specifike me këshilltarë të veçantë brenda profilit të tyre profesional.
 - Takime të ndryshme përpara vendimarrjes për çdo projekt apo buxhet me komisionet përkatëse dhe grupe interesi.
- Të pyetur se cilat janë mjetet që përdor bashkia për njoftimin e procesit të BP, të intervistuarit u përgjigjën bazuar në eksperiencën së tyre. Mënyra më e përdorshme sipas këshilltarëve të intervistuar është media sociale (90%). Të tjerat vijojnë me lajmërimin publik të afishuar në ambjentet e bashkisë (80%), lajmërimet në mediat lokale (70%) dhe posta elektronike (email) (30%). Pavarësisht se stafi i bashkisë konfirmon se regjistri elektronik ekziston, por nuk publikohet, 60% e këshilltarëve të intervistuarve e renditin atë si një nga mjetet e përdorura për njoftimin e procesit BP.
- 60% e tyre mendojnë se Këshilli ka një mekanizëm monitorimi dhe raportimi të procesit BP. Të pyetur sesi funksionon ky bashkëpunim ata shprehën se duke qenë se KB është pjesë e procesit që në fillesa, e ndjek atë hap pas hapi dhe ndërkohë është ngritur një grup ad hoc, i cili merret me rishikimin e çdo problematike që lidhet me materialet apo dëgjësat publike. Grupe këshilltarësh, qytetarësh dhe pjesë e ekzekutivit ndjekin detyrat e ngarkuara. Shumë prej tyre mendonin që ky proces kryhej nga administrata e bashkisë, kjo edhe përmes llogaridhënies në KB. Kishte opinione edhe që mediat lokale e botimet e Bashkisë Fier ishin një mjet efikas i monitorimit dhe raportimit të BP. Nga

përgjigjet e tyre lihet të kuptohet që nuk ekziston një mekanizëm i standardizuar dhe i vazhdueshëm i monitorimit të BP.

- 70% e të intervistuarve shprehen që bashkia raporton në KB për BP dhe rekomandimet që dalin prej procesit. Por vërehet paqartësi për procesin e miratimit të projekt-akteve apo vendimeve që lidhen me BP. 30% e tyre thonë që ato miratohen të përfshira në projekt-buxhetin e propozuar nga Bashkia, 40% si pikë e veçantë në mbledhjen e KB dhe 30% e tyre nuk kanë dijeni.
- Pavarësisht ndasisë të qartë politike, të gjithë të intervistuarit përgjigjen që nuk ka asnjë rast të kthimit nga Këshilli të projekt vendimeve për BP. Gjithashtu, 100% e tyre përgjigjen që KB ndjek zbatimin e të gjitha vendimeve që merren prej tyre në lidhje me BP.
- Pothuajse të gjithë këshilltarët e intervistuar kanë dijeni për mekanizmat që sigurojnë pjesëmarrjen dhe konsultimin me qytetarët për veprimtarinë e KB. Si më efektive ata rendisin faqen e internetit të Bashkisë, mediat sociale, seancat dëgjimore publike dhe buxhetimin me pjesëmarrje. Me interes ishte përmendja e Komisionit Këshillimor Qytetar si një nga këto mekanizma, si dhe konsultimi me ekspertë të fushës.
- Të pyetur në lidhje me aktet dhe dokumentat e miratuara dy vitet e fundit për të cilat janë kryer konsultime me publikun, të gjithë të intervistuarit shprehen se vendin e parë e zenë konsultimet për projektet e investimeve. Nga përgjigjet e tyre ndihet konfuzion në perceptimin e planeve strategjike, të cilat kuptohen si projekte investimesh. Projekte të tilla investimesh si stadiumi, pallati i sportit, parku i qytetit, lumi Gjanica, etj, specifikohen si plane strategjike të miratuara në konsultim me publikun.
- Këshilltarët njohin si një nga mekanizmat e matjes së kënaqësisë së qytetarëve ankesat e ardhura pranë bashkisë apo në rrugë jo formale direkt tek këshilltarët. Ato trajtohen sipas formës së përcaktuar në protokollin e bashkisë. Kjo kërkon kthim përgjigjeje sipas afateve të përcaktuara me ligj (me postë, rrugë elektronike apo përmes administratorëve të NJA-ve) ose takim direkt (verifikim) me qytetarët. 60% e tyre nuk kanë informacion mbi numrin e ankesave të trajtuara dhe 70% e tyre nuk kanë dijeni për ndonjë mekanizëm monitorimi për kënaqësinë e qytetarëve në lidhje me procesin e konsultimit publik.
- 70% e këshilltarëve të intervistuar shprehen se KB miraton raporte vjetore të hartuara nga bashkia për transparencën e proceseve vendimarrëse duke iu referuar Programit të Transparencës që bashkia e ka detyrim ligjor (Ligji 119/2014 për të Drejtën e Informimit).
- Pavarësisht se nga përgjigjet e mëparshme vërehet mosnjohje e plotë e akteve ligjore dhe nën-ligjore, standardeve dhe rregulloreve për proceset e konsultimit, 90% e

këshilltarëve të pyetur e vlerësojnë veten me kapacitete të mira/të aftë për realizimin e proceseve të konsultimit publik.

- 100% e tyre mendojnë që RAT ka patur ndikimin e vetë të ndjeshëm për zbatimin e mekanizmave për angazhimin qytetar dhe konsultimin publik, të lidhura me shtrirjen e madhe gjeografike për të kryer investime e ofruar shërbime, si dhe shtimin e burimeve në dispozicion të bashkisë për projekte zhvillimore.
- Këshilltarët rendisin një sërë sfidash që lidhen me angazhimin dhe konsultimin me publikun. Në mungesën e një modeli praktik dhe të zbatueshëm, ata sygjerojnë krijimin dhe venien në praktikë të një meknizmi që do të siguronte një rol aktiv të këshillit përgjatë gjithë procesit dhe pjesëmarrje të gjerë dhe larg politikës të qytetarëve. Të grupuara në tre kategori sfidat kryesore janë si më poshtë:
 - Indiferenca dhe apatia qytetare për të qenë pjesë e këtyre proceseve;
 - Mungesa e informacionit të saktë dhe konfuzion nga ana e qytetarëve për kompetencat e NJQV dhe afateve ligjore për zgjidhjen e problematikave;
 - Mungesa e infrastrukturës, burimeve financiare, materiale e njerëzore.
- Të pyetur për nevojat që ka Këshilli Bashkiak për përmirësimin e proceseve të konsultimit, ritheksohet nevoja e pasjes së një praktike të mirë, buxheteve dhe infrastukturës së përshtatshme dhe rritjen e shkallës së informimit dhe transparencës, paralelisht me shpeshimin e takimeve me qytetarët. Ndër nevojat e tjera që ata listojnë si të rëndësishme mund të përmendim:
 - Krijimin dhe pjesëmarrjen e strukturave qytetare në proceset konsultuese që do të përfaqësonin më mirë problematikat kolektive të komunitetit;
 - Rritjen e kapaciteteve të këshilltarëve vendorë përmes trajnimeve dhe asistencës teknike;
 - Diskutime në mediat lokale, të cilat aktualisht mungojnë.
- Rekomandimet e këshilltarëve lidhen me çështjet e mëposhtme:
 - Të ketë një standard të ri të të gjithë procesit si nga ana proceduriale ashtu dhe nga ajo materiale;
 - Të ketë një buxhet të përcaktuar, një udhëzues dhe një grup organizativ bashki dhe këshill bashkiak të paracaktuar për këtë proces;
 - Njoftimet duhet të jenë të shtrira në kohë (të publikohen disa ditë përpara) dhe në hapësirë (të jenë të aksesueshme për të gjithë qytetarët);
 - Përfshirja e sa më shumë të rinjve, OJF, grupeve të interes dhe qytetarëve të ndryshëm në këto takime;
 - Transparenca dhe rigozitet në publikimin e njoftimeve për këto takime, duke përdorur të gjitha format e mundshme me qëllim aksesimin e tij nga të gjithë qytetarët.



**Përmirësimi i Procesit të
Buxhetimit të Konsultuar
dhe me Pjesëmarrje**

**Improvement of Consulted and
Participatory Budgeting Process**